

Y A H R

YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT



Raport monitorues VI

mbi punën e ekzekutivit të komunës së Lipjanit

Nëntor 2012

Përmbajtja:

- Hyrje,
- Përmbledhje ekzekutive
- Profili i Kryetarit Shukri Buja
- Premtimet e Kryetarit Shukri Buja
- Problemet aktuale
- Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit
- Administrata komunale
- Investimet kapitale
- Drejtoria e prokurimit
- Arsimi
- Shëndetësia
- Tatimi në pronë

Adresa: Rr."Dr. Avdi Avdiu" 14000 Lipjan

Tel.+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140

e-mail: info.yahr@gmail.com

webfaqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>

<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

Hyrje

OJQ Youth Association for Human Rights (YAHR) për gjatë tërë vitit 2012 nëpërmjet monitoruesve të saj nga afër ka përcjellë punën e ekzekutivit si dhe funksionimin e legjislativit të komunës së Lipjanit. Ky monitorim ka pasur për qëllim të identifikojë jo vetëm të metat eventuale të qeverisjes si dhe shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi por edhe të shënojë ngritjen e institucioneve si në aspektin e rritjes së kapaciteteve, shfrytëzimit të buxhetit dhe aplikimit të frymës demokratike të marrjes së vendimeve si dhe të komunikimit dhe të transparencës. Gjatë procesit të monitorimit YAHR-i ka synuar të rrisë besueshmërinë e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes por edhe të sigurojë një prani të përhershme të një mbikëqyrje transparente të funksionimit të pushteteve me theks të veçantë të transparencës në raport me qytetarin. Duke u nisur nga bindja se procesi i monitorimit është i domosdoshëm për këtë shkallë të zhvillimit të demokracisë sonë, derisa ende institucionet tona përballen me ngërçe institucionale dhe me mos- transparencë, YAHR-i konsideron se me punën e monitorimit është mundësuar një dobi e dyfishtë edhe në raport me institucionet por edhe me qytetarin. Institucionet komunale kanë pasur mundësi të dëgjojnë një zë jo kundërshtues apo refuzues arbitrar, por një zë të këshillës dhe të sugjerimit për të avancuar proceset. Ndërkaq qytetari ka fituar një zë të sigurt, një vlerësim bindës për zhvillimet brenda institucioneve komunale duke mësuar kështu më mirë se kah dhe ku harxhohet paraja publike, apo si janë caktuar prioritetet e projekteve. Gjatë punës së tij YAHR-i ka hasur edhe në bashkëpunime të hapura të sinqerta dhe transparente dhe shih për këtë i falënderon të gjithë ata që kanë ofruar të dhëna dhe sqarime në çdo moment, për ne shumë të nevojshme dhe të domosdoshme për të kryer misionin tonë prej monitoruesi.

Vendimmarrja e cila prekë interesat e qytetarëve duhet të merret sa më afër tyre, këtë e siguron parimi i subsidiaritetit. Kjo u mundëson qytetarëve që të përfitojnë shërbime publike më të mira dhe në mënyrë më efikase dhe transparente nga organet komunale.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t'iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave

Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit “Qeverisja Lokale në Lipjan” bazuar në monitorimin e punës së Komunës së Lipjan gjatë periudhës Janar – Qershor 2012. Monitorimi është fokusuar në Asambleenë Komunale dhe Ekzekutivin e Komunës, dhe përfshinë fushat: transparencë dhe llogaridhënia, demokratizimi dhe qeverisja e mirë, zhvillimi urban e ekonomik, arsimi dhe shëndetësia.

Raporti gjithashtu përmban analiza kualitative të legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira mbi vetëqeverisjen lokale të cilat përdoren në lidhje me të gjeturat dhe përgjegjësitë e Komunës. Nga të gjeturat e monitorimit.

YAHR vlerëson se qeverisja në Komunën e Lipjanit ka përparime, përkundër disa problemeve në fusha të caktuara. Nga rrethi i përgjegjësive të cilin e ka, Komuna e Lipjanit është duke treguar pak rezultate të ndonjë progres në atë nivel sa të ndryshojë në mënyrë të dukshme në të mirë të qytetareve të komunës së Lipjanit.

Ekzekutivit të Komunës së Lipjanit për dallim nga viti i kaluar ka marrë me seriozitet vërejtjet dhe mangësitë të evidentuara nga Raportet e auditorit të pavarur për vitin 2011.

Probleme serioze ka edhe në fushën e zhvillimit urban në Komunën e Lipjanit. Në Lipjan ka ende disa zona për të cilat nuk është bërë planifikimi hapësinor/urban. Probleme janë evidentuar edhe në zonat ku planet rregulluese janë miratuar, probleme si rezultat i mos-planifikimit të mirë dhe mos-marrjes parasysh të kushteve në terren, dhe nevojave të zonës/qytetit.

23 Gusht 2012: Organizata Joqeveritare YAHR, nëpër mes një komunikate e ka përgëzuar punën e bërë në ndërtimin e parkut gjelbërues për gjatë rrugës “Gjergj Kastriot Skënderbeu” afër oborrit të shkollës fillore “Vëllezërit Frashëri ” në Lipjan. Tani qytetarët e Lipjanit kanë edhe një hapësirë gjelbëruese më shumë, ku mund të pushojnë dhe të kalojnë kohën e lirë në këto parqe që në të kaluarën kanë munguar. Ky është një premtimi elektorale i dhënë gjatë zgjedhjet e 2009 për kryetar komune nga kryetari i Komunës së Lipjanit Z. Shukri Buja të cilin është në rrugë të mirë për ta përmbushur. Por, kërkojë një përkushtim më të madh që këto parqe gjelbëruese të mirëmbahen dhe ruhen në të ardhmen nga ana e ekzekutivit të komunës së Lipjanit dhe njëherit kërkojmë nga ana e qytetarëve një vetëdijësim në krijimin e një kulture për ti ruajtur, kultivuar dhe për të kontribuar në mbrojtjen e këtyre parqe si prona të përbashkëta të qytetarëve të Lipjanit. Të bashkangjitur kësaj komunikate janë edhe disa foto nga parku gjelbërues tek shkolla fillore “Vëllezërit Frashëri ” në Lipjan

3 Tetor 2012: Pas një bashkëpunim në mes shoqërisë civile, pra të organizatës joqeveritare YAHR dhe të ekzekutivit të komunës së Lipjanit lidhur me hartimin e një plani të veprimit për komunitetet romë dhe ashkali. Kjo punë bashkëpunuese u konkretizua me 03.10.2012 ku është aprovuar ky dokument nga ana e kryetarit të komunës së Lipjanit z. Shukri Buja. Dokumenti ka për synim përmirësimin e mirëqenies dhe integritetin e komuniteteve Rom dhe Ashkanli në të gjitha sferat e jetës në komunën e Lipjanit. Plan komunal i veprimit për komunitetin romë dhe ashkanli është fokusuar në këto fusha: edukim, punësim , fuqizimi ekonomik, shëndetësi , çështjet sociale, strehim ,vendbanimet jo-formale, kthim , ri-integrim, kulturë, media , informim, pjesëmarrje ,përfaqësim, siguri, shërbim policor dhe drejtësi.

12 Tetor 2012: nëpër mes një komunikate YAHR-i ka shprehur shqetësimin lidhur me ndotjen e ambientit jetësor që po ndodhë në komunën e Lipjanit e në veçanti në qytetin e Lipjan nga faktori njeri. Edhe pse organizata jonë disa herë ka reaguar duke ju drejtuar drejtoratit të inspektoratit lidhur me ndotjen e

ambientit jetësor që po shkaktojnë disa biznese private (auto mekanikët, vullkanizerët etj.) dhe nga persona të pa ndërgjegjshëm të cilët janë duke djegur materie shumë të rrezikshme kancerogjene si p.sh: Goma, vajra motorike etj. të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në ambientin jetësorë dhe duke shkaktojnë në mënyrë indirekte në shëndetin e qytetarëve. Dhe njëherit ju kemi drejtuar ekzekutivit të komunës së Lipjanit, gjegjësisht drejtoratit të inspektoratit që të jetë më aktivë në ndëshkimin e këtyre personave të pa ndërgjegjshëm.

Me 16 Tetor 2012: Organizata jonë YAHR ka shprehur shqetësimin lidhur shfaqjen në mënyrë të organizuar nga drejtoria komunal e kulturës të filmit të Halil Budakovës "Shkolla e maleve" për nxënësit e shkollave fillore. Në vend se drejtoria komunal e kulturës, rinisë dhe sportit që të organizojë ndonjë shfaqje filmike me karakter edukativë, ka organizuar shfaqje filmike me skena të dhunës, dhe me efekte speciale të vrasjeve dhe paramendoni se kujt i është shfaqur? Pra, për grup moshat nga 6-12 vjeçare duke mos llogaritur për pasojat dhe ndikim negativ tek fëmijët. Dhe natyrisht lindë pyetja kush mban përgjegjësi për këtë ndikim negativë tek fëmijët tanë?... Ne si organizatë nuk kemi asgjë të bëjë me filmin e producentit Halil Budakovës dhe për kundër e çmojmë shumë vlerat e tija si film artistikë, por nuk mendojmë se drejtoria jonë komunale se ka bërë një përzgjedhje të mirë. Ky film është për kategori të moshave mbi 14 vjeçare. Ky organizimi i tillë i shfaqjes së këtij filmi është në kundërshtim me ligjin për Kinematografinë nr.2004/22 të datës 08.07.2004. Ku së pari duhet të merë vlerësimin nga komisioni i vizionimit, se në të cilën kategori bënë pjesë e pastaj ti shfaqet audiencës përkatëse.

Më poshtë po e citojmë pjesët e ligjit për kinematografinë: Neni 50.2.Komisioni i Vizionimit i vlerëson filmat dhe jep leje për shfaqjen publike të filmave sipas nenit 10 të këtij ligji. Ndërsa, Neni 10 thotë: 10.1.Komisioni i Vizionimit të QKK jep leje në kuptim të nenit 9 (Për çdo film vendës apo të huaj që synohet të shfaqet publikisht, para se të ketë shfaqjen e parë në Kosovë, distributori, përkatësisht shfaqësi duhet të merr lejen për shfaqjen publike të filmit.) të këtij ligji sipas kategorive të mëposhtme:

- a) kategoria 'A' – kur filmi lejohet për të gjitha moshat dhe pa kufizim në aspektin e kohës të projektimit publik,
- b) kategoria 'B' – kur filmi lejohet për të gjithë banorët mbi 14 vjeç,
- c) kategoria 'C' – kur filmi lejohet për të gjithë banorët mbi 18 vjeç,

10.3.Filmat e pajisur me leje që përmbajnë skena të dhunës së theksuar, skena tmerri, skena të dhunës në familje ose të dhunës a të keqtrajtimit të fëmijëve, mund të shfaqen për publik pas orës 22,00.

Fëmijët munden vetëm një pjesë të sasisë të informacioneve t'i përpunojnë. Filmi me ndërrim të shpejtë të pamjeve dhe efekte speciale shkakton një vërshim ngacmimesh, që para se gjithash fëmijët e njomë nuk mund t'i përballojnë. Fëmijët reagojnë për këtë me shqetësim. Fëmijët e njomë nuk munden po ashtu ta bëjnë dallimin në mes të vërtetës dhe trillimit. Dhuna në film i tremb dhe i frikëson ata. Së pari diku në moshën 9 vjeçare fëmijët munden t'i kuptojnë, filmin dhe realitetin, si dhe të dallojnë shtjellimet e komplikuar. Fëmijët dhe të rinjtë janë blerësit më të fortë të informacioneve, të cilat janë të dedikuara posaçërisht për një publik të caktuar. Ne nuk kemi mundësi në ditët e sotme, që publicitetit t'i shmangemi plotësisht, për këtë duhet që prindërit me fëmijët e tyre të diskutojnë mbi kuptimin dhe qëllimin e këtyre mesazheve. Analistët e filmit, që herët kanë arritur në përfundimin, se leximi i fotografisë, kryhet e kuptohet ndryshe nga fëmijët, dhe ndryshe nga të rriturit. Duke mos minimizuar edhe nivelin edukativo – arsimor në familje do të duhej që prindërit të vendosin kufijtë, jashtë simpatisë dhe dëshirave që kanë për fëmijët e tyre, për mos ndjekjen e filmit. Kufirin "e shëndoshë" por (mos)shikueshmërinë e filmit dhe emisioneve, do të duhej ta komentonin analistët, kritikët e filmit, sociologët, pedagogët dhe psikologët. Në të gjitha shoqëritë njerëzit e sëmurë gjejnë trajtimin mjekësor, kur këta kanë nevojë për të.

Ky fenomen ka zënë rrënjë në psikologjinë tonë dhe këtë e dëshmojnë edhe vrasjet, ngatërresat dhe dhuna e përgjithshme shoqërore. Perpos luftës dhe dhunës serbe, pa dyshim "kontributin" në këtë të keqe, padyshim, ka dhënë edhe "TV shqiptare"...

Profili i Kryetarit Shukri Buja



Shukri Buja u lind më 27.08.1966, në fshatin Bujan, komuna e Lipjanit, shkollën fillore e kreu në fshatrat Bujan dhe Kraishtë ndërsa shkollën e mesme në Lipjan. Është i diplomuar në gazetari dhe ka përfunduar provimet e magjistraturës në drejtimin e Shkencave Politike dhe Administratës Publike në Universitetin e Prishtinës.

Në nëntor të vitit 1998 emërohet komandant i Zonës Operative të Nerodimes. Pas përfundimit të luftës emërohet Komandant i zonës së gjashtë të TMK-së me gradën Gjeneralmajor. Është dekoruar nga KPA (Këshilli i Përkohshëm Administrativ me dekoratën Urdhër “ Adem Jashari”) si dhe nga Gjenerali amerikan z. Kraedok etj. Nga viti 2007 kryetar i Komunës së Lipjanit në dy mandate.

Premtimet e Kryetarit Shukri Buja


Organizata Joqeveritare **Youth Association For Human Rights – YAHR** kemi monitoruar aktivitetet dhe premtimet e kryetarit Shukri Buja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin e organizuar nga ne dhe gjithashtu nga dy debatet të mbajtura në “Jeta në Kosovë”, në mes të tjerash Kryetari Buja ka premtuar:

Premtimet	vlerësimi
Krijimi i zonës së re industriale në Kërqevë për akomodimin e 200 Bizneseve dhe punësimin e 2000 personave	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Fillimin e ndërtimit të zonës industriale me sipërfaqe 20 ha afër QMI-së dhe punësimin e 800 personave	ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
Krijimin e Lipjanit si qendër agrobiznese	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Renovimin e të gjitha shkollave dhe krijimin e kushteve hapësinore për zvogëlimin e numrit të nxënësve në klasë nga 37 në 25	procesi ka filluar në rrugë të mirë
Zgjerimin e rrugëve kryesore të qytetit në katër korsi të qarkullimit	ka hapa konkrete në realizimin e premtimeve
Asfaltimin e rrugëve në të gjitha lagjet e qytetit	ka hapa konkrete në realizimin e premtimeve
Krijimin e hapësirave të mjaftueshme të	ka hapa konkrete në realizimin e premtimeve

parqeve si dhe parkingjeve publike	
Futjen e rrjetit të kanalizimit në të gjitha fshatrave mbi 150 km	procesi ka filluar në rrugë të mirë
Asfaltimin rrjetit rrugore mbi 70 km	të realizuar plotësisht
Sistemin e rrjetit të ujësjellësit mbi 100 km	të realizuar plotësisht
Ndërrimin e pllakave në dysheme, dyerve dhe dritareve në Q.K.M.F në Lipjan	të realizuar plotësisht
Zvogëlimin e papunësisë dhe të varfërisë	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Mbështetjen e ekonomive familjare	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Riaktivizimin dhe pasurimin e bibliotekave shkollore	ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
Hartimin e projekteve bujqësore	ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
Rregullimin dhe zgjerimin e sheshit “Adem Jashari”	ku procesi ka filluar në realizimin e premtimit por me ngecje
Krijimin e lehtësirave administrative dhe teknike për nxitjen e investimeve të huaja	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Uljen e taksave mbi investimet që krijojnë vende pune	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Renovimin e të gjitha shkollave dhe kompletimin me infrastrukturë me qëllim të krijimit të kushteve sipas standardeve evropiane	ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
Rregullimin e nxehjes qendrore në të gjitha shkollat dhe rregullimin e rrethove të oborreve të shkollave sipas modelit të shkollës “Mehmet Akif”	ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
Përmirësimin e infrastrukturës sportive	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Sinjalizimin horizontal dhe vertikalë të rrugëve	ku procesi ka filluar në realizimin e premtimit por me ngecje
Transporti publik urban dhe ndër urban me mjete transporti uniforme	të realizuar plotësisht
Furnizimi të pandërprerë me ujë të pijshëm dhe trajtimin e ujërave të zeza	ka hapa konkrete në realizimin e premtimeve
Ndriçimin e të gjitha rrugëve të qytetit	ka hapa konkrete në realizimin e premtimeve
Zgjerimin e qytetit në drejtim të lumit sitnica, si dhe rregullimin e shtratit të lumit, parqeve dhe pushimoreve përgjatë lumit në sipërfaqe 250 ha	ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
Implementimin e vendimit të KK Lipjanit për lagjen e kategorive të luftës së UQK-së	ku procesi ka filluar në realizimin e premtimit por me ngecje
Përkrahje e vazhduar e familjeve të dëshmoreve dhe martirëve të luftës	ka hapa konkrete në realizimin e premtimeve
Punësimin e rasteve sociale;	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Sistemimin e veteranëve të luftës dhe	ku procesi ka filluar në realizimin e premtimit por me

kategorive të dala nga lufta;	ngecje
Krijimin e hapësirave ku rinia do të zhvillojë aktivitetet sportive dhe kulturore;	ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
Renovimin e shtëpisë së kulturës si dhe funksionimin e sferave të kulturës, si kinematografisë, artit skenik dhe të gjitha ato fusha që i kërkon rinia lipjanase;	të realizuar plotësisht
Digjitalizimin e bibliotekës së qytetit;	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Administratë digjitale;	ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
Renovimin e stadiumit të qytetit;	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Ngrohjen qendrore me energji alternative për qytetin e Lipjanit (me metan, drithëra dhe sillaxhë ku do të përfitojnë edhe bujqit, projekt ky me koncesion dhe investim i një firme nga Lozana, projekt i cili do të përfundoj brenda tre vjeçarit të qeverisjes);	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Për fshatin Smallushë: rregullimin e gjithë infrastrukturës; ndërtimin e një shkolle të re dhe një fushe të futbollit;	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Për banorët e Gadimes: ndërtimin e një objekti të ri shkollor me përmasa më të mëdha dhe me ambiente më moderne; asfaltimin e të gjitha rrugëve të brendshme;	procesi ka filluar në rrugë të mirë
Arsim cilësor duke ndërtuar infrastrukturës të shkollës me pedagog, mjek dhe psikolog dhe me ngrohje qendrore;	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Krijimin e 5 mijë vendeve të reja të punës;	ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
Ndërtimin e dhjetë fabrikave;	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Zhvillimin e turizmit;	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
Përpunimin e plehrave të pulave në mënyrë që të largohet era nga ferma e pulave;	pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,

- 16 premtime ose 37.20% pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
- 9 premtime ose 25.58% ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
- 4 premtime ose 11.62% ku procesi ka filluar në realizimin e premtimit por me ngecje,
- 3 premtime ose 9.30% procesi ka filluar në rrugë të mirë,
- 6 premtime ose 9.30% ka hapa konkrete në realizimin e premtimeve,
- 5 premtime ose 6.97% të realizuar plotësisht.



Problemet aktuale

Edhe pse një komunë me një pozitë të përshtatshme gjeografike dhe me potenciale të mëdha për zhvillim ekonomik, qytetarët e Komunës së Lipjanit përballen me të njëjtat problema sikurse pjesa tjetër e Kosovës. Edhe në këtë komunë brenga më e madhe e qytetarëve mbetet papunësia dhe varfëria. 48.91% e qytetarëve në këtë komunë janë të papunë. 12.16% e qytetarëve janë të varur nga ndihmat sociale. Përveç këtyre problemeve, probleme më specifike për komunën e Lipjanit janë:

- Mungesa e ngrohtores së qytetit;
- Kundërmimi nga ferma e pulave;
- Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike.

Mungesa e ngrohtores së qytetit. Nuk ka lëvizje në këtë drejtim, edhe pse ne kemi bërë vërejtje që nga raporti e parë mbi punën e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit dhe që është premtim më kryesor nga fushata zgjedhor që nga 2007-ta dhe 2009-ta nga kryetari i komunës Z. Shukri Buja.

Kundërmimi nga ferma e pulave. Banorët në dalje të qytetit të Lipjanit, në drejtim të fshatit Banullë, kanë problem kundërmimitin e erërave që vijnë nga ferma e pulave që ndodhet në afërsi të udhëkryqit për në Janjevë. Nga erërat që fryjnë, kundërmimi nga ferma e pulave mbërrin deri në qendër të qytetit, por më së shumti kanë problem banorët që ndodhen në afërsi të kësaj ferme.

Mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike. Në këtë drejtim kemi një ndryshim nga raporti i kaluar, se kemi një iniciativë nga kryetari të komunës me një projekt të turizmit për zhvillim rural në Komunën e Lipjanit, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe komuna e Lipjanit implementim e së cilit do ta bëjë ISDY.

Transparenca dhe llogaridhënia

Në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies, që paraqesin dy prej shtyllave kryesore të funksionimit të institucioneve publike, Komuna e Lipjanit gjatë gjashtë muorit të dytë të këtij viti 2012 ka qenë e mbyllur

për qytetarë dhe OJQ-të. Ndër premtimet kryesore të Kryetarit Shukri Buja ka qenë edhe transparenca dhe llogaridhënia si dhe bashkëpunimi shoqërinë civile.

Organizata joqeveritare YAHR ka shpreh shqetësimin e bllokimit të gjitha kërkesave të organizatës sonë në qasjen e dokumenteve zyrtare komunale. Vetëm gjatë muajit tetor 2012 janë kërkuar një numër i madhe dokumentesh nga organizata jonë me qëllim të bërjes transparente disa aktiviteteve të institucioneve komunale, por që në këtë rast kemi marrë përgjigje negative dhe në disa raste nuk na janë përgjigjur fare edhe pse ligji për qasje në dokumentet publike Nr. 03/L-215 të datës 07.10.2010 i obligon institucionet publike që brenda shtatë ditëve të jep një përgjigje ndaj parashtruesit të kërkesës. Ku po e citojmë neni 7 paragrafi 8 ku thuhet: Përpunimi i kërkesave për qasje në dokumente zyrtare Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj.

Ne kemi kërkuar nga zyrtari për informimi i komunës së Lipjanit që të na mundësoj qasjen në dokumentet që kanë të bëjë me:

- Numrin e pjesëmarrësve të zyrtareve komunal në trajnime të ndryshme të organizuara jashtë dhe brenda shtetit,
- Dokumentet që kanë të bëjë me marrjen e mëditjeve zyrtarët komunal dhe shuma e pagesave të mëditjeve,
- Dokumentet që kanë të bëjë me numrin e trajnimeve me pagesë,
- Sa është siguruar infrastruktura përcjellëse në këto trajnime nga ana e komunës, si p.sh: transporti etj. nuk na janë përgjigjur.

Ndërsa, sa i për ketë organizimit të debateve për planifikimet buxhetore 2013 me qytetareve. Ekzekutivi i komunës së Lipjanit ka organizuar dëgjime buxhetore nëpër shtatë vendbanime (*Shalë, Magure, Gadime, Sillovi, Janjevë, Lipjan dhe në Grackë e Vjetër*) të ndryshme me qytetarët e komunës së Lipjanit. Por, kemi një mos interesim për pjesëmarrje nga qytetarët e komunës së Lipjanit në këto debate. Organizata jonë gjatë monitorimit të këtyre aktiviteteve të ekzekutivit të komunës ka vërejtur disa faktorë që kanë ndikuar në një pjesëmarrje të ultë të qytetarëve :

1. Mos informimi me kohë dhe jo i saktë i mbajtjes së këtyre debateve nga ana e komunës së Lipjanit,
2. Mos puna dhe mos angazhimi i kryesive të këtyre fshatrave,
3. Mungesa e njohurive të qytetarëve të këtyre lokaliteteve mbi rendësin e organizimit të këtyre debateve me qytetarët dhe mos njohurin e shfrytëzimit të mekanizmave ligjore të cilët janë në favor të tyre që kërkesat dhe interesat e tyre që të realizohen.
4. Dëshpërimi i qytetareve mbi mundësin e ndikimi të tyre tek institucionet komunal.

Edhe pse pjesëmarrja e qytetareve ka qenë e dobët në këto debate, vërehet edhe një mungesë e theksuar e mos angazhimit të përfaqësuesve të fshatrave në definimin e prioritetëve apo nevojat e fshatrave të cilët i përfaqësojnë. Ku nuk kemi një definim të qartë të kërkesave dhe nevojave të tyre. Andaj, lindë nevoja për një angazhim konkret të institucioneve të pushtetit lokale në komunën e Lipjanit që së bashku me shoqërinë civile që të angazhohen maksimalisht në gjetjen e mekanizmave që të ngritët pjesëmarrja e qytetarëve në mënyrë aktive në proceset vendimmarrëse.

Ne si organizatë joqeveritare i rekomandojmë institucionet lokale komunale të komunës së Lipjanit që në të ardhmen kurrë të organizohen debate të tilla që të merren këto rekomandime parasysh:

- Territori i komunës së Lipjanit që të ndahet në pesë zona: Shalë, Magure, Gadime, Sillovi dhe Janjevë. Dhe P.SH: kurrë të organizohet debati në Magure që të ftohen qytetaret e fshatrave për rreth si që është: Qylaga, Dy Dobrajat, Blinaja, Leletiqi, Medveci, Vrella, Poturovci, Torina, Ribari Madhe , Ribari i Vogël etj.
- Të ketë një informim me kohë dhe i saktë i qytetareve lidhur me organizimin e këtyre debateve dhe të informohen mbi rendësin e pjesëmarrjes së tyre në këto debate.
- Të merren parasysh kërkesat e atyre qytetareve që janë më aktiv se të tjerët.

Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit për nëntëmuajorin e vitit 2012 ka arrit që të shpenzohet në masën 64.17 % ose 7,571,225.81 € nga buxheti i planifikuar 11.795.467,676€ për vitin 2012. Kjo shifër është shifra më e ultë që është arritur ndonjëherë në shpenzimin e buxhetit në këtë komunë. Mirëpo, pjesa më e madhe e pritët të shpenzohen gjatë tre muajorit të fundit të 2012..

Shpenzimet buxhetor gjatë periudhës nëntë mujore 2012				
Fondi Burimor	Buxheti I planifikuar	Shpenzimi	Diferenca	%
GRANTI QEVERITAR	9,960,214.00	6,740,607.37	3,219,606.63	67.68
TE HYRAT VETANAKE	1,499,999.96	568,868.27	931,131.69	37.92
TE HYRAT VETANAKE	331,964.89	254,834.17	77,130.72	76.77
DONACIONET E BARTURA	7,343.60	6,916.00	427.60	94.18
Gjithsej:	11,799,522.45	7,571,225.81	4,228,296.64	64.17


Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencione t dhe transfere	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2013	6,780,898 ▲	1,199,710 ▲	256,600 ▲	150,000 ▲	3,586,883 ▲	11,973,991 ▲
2012	6,730,900 ▲	500,953 ▼	120,000 ▼		2,608,361 ▼	11,795,467 ▲
2011	6,502,293 ▲	655,043. ▲	123,464.	85,202. ▲	3,951,609 ▲	11.317.613 ▲
2010	4,758,026 ▲	513,941 ▲	118,443 ▼	80,000 ■	2,986,007 ▲	8,456,417 ▲
2009	4,425,264 ▲	512,394 ▼	112,154 ■	80,000 ■	2,325,154 ▲	7,454,966 ▲
2008	3,868,282 ▲	554,288 ▲	112,154 ▼	80,000 ■	1,239,909 ▲	5,854,633 ▲
2007	3,718,294 ▼	537,335 ▼	202,154 ▲	80,000 ▼	1,127,138 ▲	5,664,921 ▲
2006	3,731,341 ▲	610,147 ▼	78,577 ▼	100,000 ▲	1,070,849 ▼	5,590,914 ▼
2005	3,696,996 ▼	621,827 ▼	126,381 ■	64,000 ■	1,180,077 ▲	5,689,281 ▲
2004	3,701,207 ▲	1,135,854 ▼	-	-	721,431 ▲	5,558,492 ▲
2003	2,770,014 ■	1,144,006 ■	-	-	465,113 ■	4,528,532 ■

▲ Rritje, ▼ Zvogëlim, ■ Nivel i njëjtë/mos ndryshim


Administrata komunale

Në vitin 2012, në Komunën e Lipjanit kemi ulje të numrit të punëtorëve në krahasim me një vit më parë, (si pasojë largimit nga lista e punëtorëve të shërbimit të zjarrfikësve) në tre sektorët publik: arsim 1,068, shëndetësi nga 233 , administratë nga 205 në vitin 2011 në 185 në vitin 2012 janë të punësuar gjithsej 1,483 qytetarë. Vetëm në administratën komunale janë të punësuar momentalisht 185 shërbyes civil që do të thotë 20 shërbyes civilë më pak krahasuar me një vit më parë.. Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 10/46, ku sipas së cilit në komunat me popullsi nën 100,000 banorë administratat lokale duhet të kenë 1 shërbyes civil për 620 banorë, del se komuna e Lipjanit me rreth 60,000 banorë duhet të ketë më së shumti 97 shërbyes civil. Sipas kësaj, administrata komunale e Lipjanit është e tej ngarkuar me staf. Duke u bazuar në statistikat e strukturës kualifikuese të administratës së komunës së Lipjanit shumica e punëtorëve janë me shkollë të mesme, vetëm 35% prej tyre janë me përgatitje të lartë, gjegjësisht me fakultet.

Struktura kualifikuese e administratës komunale



Struktura gjinore



Deklarimi i pasurisë të zyrtareve të lartë komunal të komunës së Lipjanit 2012

Deklarimi i pasurisë të zyrtareve të lartë komunal të komunës së Lipjanit 2012		PASURIA E PALUATSHME	PASURIA E LUATSHME	AKSIONEVE NË SHOQËRI KOMERCIALE	PARA TË GATSHME TË MBAJTURA NË INSTITUCIONE FINANCIARE	DETYRIMET FINANCIARE NDAJ PERSONAVE JURIDIK DHE FIZIK	TE HYRAT VJETORE	TOTALI I KAPITALIT
1	Ragip_Zejnullahu	840,000.00	0.00	0.00	0.00	134,500.00	775.00	706,275.00
2	Shukri_Buja	339,000.00	20,000.00	0.00	58,000.00	20,000.00	109,000.00	506,000.00
3	Xhavit_Ilazi	361,500.00	14,000.00	0.00	0.00	3,600.00	3,384.00	375,284.00
4	Avni_Limani	280,000.00	25,000.00	0.00	15,208.00	0.00	11,700.00	331,908.00
5	Petrit_Kelmendi	280,000.00	0.00	0.00	1,981.00	0.00	8,300.00	290,281.00
6	Mendim_Luma	205,000.00	10,300.00	0.00	0.00	7,000.00	15,154.00	223,454.00
7	Bajram_Rizani	101,000.00	12,500.00	0.00	0.00	400.00	19,500.00	132,600.00
8	Agim_Bylikbashi	69,000.00	0.00	0.00	700.00	0.00	5,652.00	75,352.00
9	Haqif_Drenica	77,000.00	0.00	100.00	0.00	19,000.00	6,300.00	64,400.00
10	Banush_Bytyci	66,600.00	0.00	0.00	1,750.00	15,400.00	1,307.00	54,257.00
11	Arsim_Sahiti	44,500.00	5,400.00	0.00	0.00	10,000.00	9,001.00	48,901.00
12	Halit_Gashi	55,700.00	0.00	0.00	0.00	20,000.00	6,192.00	41,892.00
13	Safet_Krasniqi	23,000.00	2,000.00	0.00	1,730.00	0.00	12,715.00	39,445.00
14	Nazmi_Krasniqi	30,000.00	6,200.00	0.00	0.00	10,650.00	12,600.00	38,150.00
15	Florent_Hoxha	16,500.00	0.00	0.00	0.00	0.00	12,456.00	28,956.00
16	Shpejtim_Ballabani	0.00	2,000.00	0.00	100.00	182.00	3,800.00	5,718.00

Investimet kapitale

Në periudhën janar-tetor 2012, buxheti i ndarë për investime kapitale 2,986,007 € është realizuar në masën 47.81 %. Nga të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2012 nga 1,500,000.00€ deri në fund të muajit shtator janë realizuar 717,494.90 € ose 47.83 %. Kuvendi Komunal i Lipjanit ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2013- 2015. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Lipjanit do të ketë në dispozicion 11,008,057.00 € për investime kapitale.

Planifikimi dhe realizimi i te hyrave vetanake 2012- Lipjan	Planifikimi 2012	Realizimi 2012	Indeksi %
Administrata			
Taksa certifikata tjera ofiqari	39,287.00	40,135.50	102.16
Taksa tjera administrative	8,000.00	6,553.00	81.91
Te hyrat nga shitja e mallrave (shitblerja e banesave)		5,174.61	
Prokurimi			
Taksa tender	2,000.00	1,240.00	62.00
Buxheti			
Takse rrugore	80,000.00	53,881.00	67.35
Tatimi ne prone	390,000.00	297,693.92	76.33

Taksa tjera administrative	1,000.00	105.00	10.50
Ekonomi			
Licenca tjera për afarizëm	155,000.00	66,193.20	42.71
Qiraja nga objektet publike	71,000.00	17,191.36	24.21
Shfrytëzimi i hapësirës afariste (aeroport)	157,000.00	4,858.07	3.09
Inspektorati			
Gjobat mandatorë	3,000.00	110.00	3.67
Pranimi teknik i lokalit	8,000.00	3,225.00	40.31
Gjeodezi			
F. poseduese, kopje plani	40,000.00	13,433.00	33.58
Bartje e pronës dhe hipotekat	125,000.00	37,771.00	30.22
Matje ne teren	20,000.00	12,078.00	60.39
Urbanizëm			
Leje ndërtimi	150,000.00	43,589.04	29.06
Shndrr. tokës bujq. ne ndërtimore	15,000.00	16,303.66	108.69
Takse leje ndërtimi	1,000.00	675.00	67.50
Takse për rrëime te objekteve		50.00	
Shërbime publike			
Largimi dhe deponimi i automjeteve(merimanga)	1,000.00	0.00	0.00
Shfrytz. i haps. afariste	3,000.00	4,095.04	136.50
Kulture RS			
Taksat nga te hyrat e bibliotekave	1,787.00	504.50	28.23
Qiraja nga objektet publike	1,000.00	485.00	48.50
Gjithsejte:	1,272,074.00	625,344.90	49.16
Participim nga çerdhja	22,000.00	16,746.50	76.12
Participim nga shëndetësia	44,713.00	24,732.50	55.31
Participim i qytetareve		0.00	
Gjithsej:	1,338,787.00	666,823.90	49.81
Gjobat e trafikut	50,000.00	12,566.00	25.13
Gjobat e gjykates	111,213.00	38,105.00	34.26
Gjithsej:	1,500,000.00	717,494.90	47.83 %

Drejtoria e prokurimit

Në drejtorin e prokurimit janë gjithsejtë gjashtë persona të punësuar dhe krahas ekzistimit të pozitës së drejtorit të prokurimit është funksionale edhe pozita e shefit të prokurimit.

Komuna e Lipjanit, gjegjësisht drejtoria e prokurimit ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Asfaltimi i rrugës në fshatin Sllovi”. OE “Bejta Commerce”-Gjilan i pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës nga ana e AK-KK LIPJAN OE “NPSH-BAGERI”-Ferizaj për tenderin në fjalë ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së me pretendimin se AK ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së sic janë: nenet 6-Ekoniciteti dhe Efikasiteti, 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, 28- Specifikimet teknike, 51-Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes, 52-Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës, 54-Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar, 59-Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale. OSHP-ja pas pranimit të ankesës ka autorizuar ekspertin shqyrtues që ta ekzaminojë lëndën, i cili në raportin e tij ka konstatuar se AK në këtë aktivitet prokurimi nuk i ka zhvilluar procedurat komfor

nenit 59 të LPP-së dhe gjithashtu ka konstatuar se nuk i ka respektuar nenet 6,7 dhe 60 të LPP-së, prandaj ankesën e OE ankues e ka cilësuar si të bazuar dhe ka rekomanduar që lënda të kthehet në ri-vlerësim. AK me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues ka mbajtur seancën dëgjimore.

Në seancën dëgjimore të gjitha palët kanë paraqitur argumentet e tyre por më rëndësishmja është që eksperti shqyrtues ka ngritur edhe një çështje shumë shqetësuese e cila është : hapja e tenderit është bërë me datë 20.07.2012 ndërsa vërtetimi i ATK-së i OE të rekomanduar për kontratë në dosje të tenderit figuron i nxjerr me dt. 01.08.2012, fakt i cili ngjallë dyshime për ndërhyrje të parregullta në dokumentacion. Paneli Shqyrtues pas shoshitjes së të gjitha argumenteve të paraqitura ka konstatuar se AK-KK LIPJAN procedurën nuk e ka ekzekutuar konform nenit 59 të LPP-së, duke mos e rekomanduar për kontratë OE të përgjegjshëm me çmim më të ulët dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar nenin 6 dhe 7 të LPP-së, duke i trajtuar në mënyrë të jo-barabartë dhe diskriminuese Operatorët Ekonomik. Për këtë arsye ankesën e OE ankues e ka gjetur të bazuar dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Kompanitë fituese te tenderëve nga ana e prokurimit gjatë vitit 2010 dhe 2011			
	Kompanitë fituese të tenderëve	Selia	Totali €
1	Budakova	Lipjan	934,381.92
2	Linda shpk	Ferizaj	780,218.04
3	Drenica	Prishtine	684,499.72
4	Te Muhameti	Lipjan	650,983.64
5	Stublla	Lipjan	483,684.50
6	Bageri	Ferizaj	466,675.10
7	M-Gashi	Lipjan	456,099.17
8	Papenburg&Adriani	Sojeve	403,549.95
9	Mendi	Drenas	320,587.03
10	Gashi-Ing	Suharekë	263,321.94
11	Dino	Lipjan	247,072.00
12	NNT ":B-ST"	Fushë Kosovë	200,000.00
13	Muratori	Drenas	197,262.03
14	Dimi Bau	Lipjan	160,932.50
15	Qendrimi	Lipjan	158,054.60
16	Euro-toni	Lipjan	156,600.76
17	Standard -Benz	Lipjan	147,556.00
18	Bejta - comerce	Gjilan	116,914.00
19	Rexha-Com	Lipjan	115,808.95
20	Oinsi	Prishtine	99,500.00
21	Eskavatori	Ferizaj	98,059.76
22	Remi	Lipjan	95,694.10
23	Agoniti & metali	Suhareke-Pozharan	87,197.60
24	Lavdimi	Lipjan	70,631.80
25	Burimi	Malisheve	70,095.00

Planifikimet vjetore për investime kapitale të Komunës së Lipjanit për vitin 2012

Projektet	Të planifikuara	Realizimi
Meremetimi I zyrave pritëse	20,000.00	Jo
Blerja e teknologjisë informative	10,000.00	Po
Blerja e veturave K.K. Lipjan	80,000.00	Po
Asfaltimi I rrugës „Lidhja e Prizrenit katër Korsi" me infrastrukturë përcjellëse	700,000.00	Në proces
Asfaltimi I rrugës Vrell e Gadimës	130,000.00	Jo
Asfaltimi I rrugës-Silovi	100,000.00	Në proces
Asfaltimi I rrugës në fshatin Shalë	150,000.00	Në proces
Asfaltimi I rrugëve të qytetit të Lipjanit: Aziz Kelmedi,Mihajlo Pupin, Grupi Rinor Shqiptar, Hysen Jashanica,Isa Demaj, Jetish Akllapi, Qazë Lugaxhia.	200,000.00	Në proces
Ndërtimi I kanalizimit-Kraishtë	200,000.00	Në fazën e vlerësimit
Ndërtimi I kanalizimit-ne lagjen e re Lipjan	150,000.00	Në fazën e vlerësimit
Kanalizimi ne fshatin Gadime faza-II-	250,000.00	Është në fazën përfundimtar e
Ndërtimi I Kanalizimit Janjevë	114,760.00	Në proces
Ndërtimi I kanalizimit-Krojmir	100,000.00	Në proces
Ndërtimi I kanalizimit-Smallushë Faza e parë	150,000.00	Para përfundimit
Ndërtimi I kanalizimit-Lipjan,,Lagjia Akllapi"	200,000.00	Në proces
Realizimi I ujësjellësit ne fshatrat: Kraisht, Grack e Vogël, Bujan,Topliqan	250,000.00	jo
Realizimi I ujësjellësit Llugaxhi	63,888.00	I përfunduar
Realizimi I ujësjellësit Smallushë	50,000.00	I përfunduar
Bashkëfinancim me Donatorë	170,000.00	Në proces
Rregullimi varrezave ne fshatin Bujan-masakrra e Bujanit	50,000.00	Në proces
Ndërtimi I Kanalizimit ne fshatin Magure	200,000.00	Në proces
Rregullimi i Parqeve të Qytetit	80,000.00	Në proces
Hartimi I Projekteve detale	178,000.00	Në proces
Renovimi I QKMF-Së në:(Janjevë dhe Magure)	112,000.00	Në proces
Ndërtimi I Qerdhes -Lipjan	150,000.00	Jo, mjetet janë ri destinuar
Ndërtimi I shkollës Filllore Rubovc	100,000.00	

Investimet e planifikuara kapitale të Komunës së Lipjanit për vitin 2013		Kostoja totale	Transferim qeveritare
1	Pagesa për vendime gjyqësore	30,000.00	30,000.00
2	Asfaltimi I Rrugës,,Hajredin Bajrami"ne Lipjan me katër korsi	500,000.00	500,000.00

3	Kanalizimi fsh. Janjevë	150,000.00	100,000.00
4	Asfaltimi I rrugës në fshatin-Gllanicë	150,000.00	150,000.00
5	Kanalizimin fshatin-Rubovc	100,000.00	100,000.00
6	Ndërtimi i shtëpizës në oborrin e varrezave në fshatin-Grack e vjeter	30,000.00	
7	Asfaltimi i rrugëve ne qytetin e Lipjani: Lagjeja e Varoshve, Mbretesha Teut,2 korriku, Shaqir Hoxha,Ulpiana,12 Qershori	100,000.00	100,000.00
8	Rregullimi I trotuareve ne qytetin e Lipjanit	70,000.00	70,000.00
9	Rregullimi I trotuareve ne fsh: Gadime e Eperme-Gadime e Ulet	125,705.00	
10	Asfaltimi në fsh-Poturovc	100,000.00	100,000.00
11	Asfaltimi në fshatin-Dobraj e Vogël	100,000.00	100,000.00
12	Asfaltimi në fshatin-Hallaq I Vogël	100,000.00	100,000.00
13	Kanalizimi në fshatin-Konjuh	110,000.00	110,000.00
14	Kanalizimi në fshatin-Torinë	100,000.00	100,000.00
15	Kanalizimi në fshatin-Gllavicë	60,000.00	60,000.00
16	Kanalizimi në fshatin-Hallaq i Madhë	100,000.00	100,000.00
17	Kanalizimi në fshatin-Marevcë	60,000.00	60,000.00
18	Kanalizimi në fshatin-Qallapek	100,000.00	100,000.00
19	Kanalizimi në fshatin-Qylagë	100,000.00	100,000.00
20	Kanalizimi në fshatin-Risinovc	100,000.00	100,000.00
21	Kanalizimi në fshatin-Blinajë	100,000.00	100,000.00
22	Kanalizimi në fshatin Bregu I Zi	100,000.00	100,000.00
23	Kanalizimi në zonën e re te qytetit te Lipjanit Z1.3 dhe Z1.4	50,000.00	
24	Asfaltimi I Rrugës zonën e re te qytetit te Lipjanit Z1.3 dhe Z1.4	60,000.00	
25	Kanalizimi në fshatin-Baicë	148,746.00	27,231.00
26	Ujësjiellësi për 18 fshatrat: Leletiqi, Vershevc, Zllakuqan, Ribari I Madhë, Kraishtë,Varigoc,Bregu I Zi, Bujan,Grack e Vogël, Topliqani, Dobraj e Madhe, Dobraj e Vogël, Magure, Medvec, Llugë, Qylagë, Torinë, Poturovc	200,000.00	
27	Mirëmbajtja e rrugëve te Asfaltuara	50,000.00	
28	Mirëmbajtja e Ndriçimi Publik	25,000.00	
29	Bashkëfinancim me donator	122,523.00	
30	Sinjalizim Horizontal dhe Vertikal	25,000.00	25,000.00
31	Hartimi i projekteve detale	130,000.00	130,000.00
32	Renovimi i ambulanteve	124,696.00	124,696.00

33	Ndërtimi I shkollës fillore në fshatin-Bujari	165,213.00	165,213.00
	TOTALE SHPENZIMET KAPITALE	3,586,883.00	2,752,140.00

Arsimi

Para nisjes së mandatit të dytë nga kryetari aktual Shukri Buja sistemi arsimor në Lipjan është përballur me këto probleme kryesore:

1. Gjendja jo e mirë e infrastrukturës shkollore;
3. Numri i madh i nxënësve për paralele në shkollat e mesme;
3. Mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik;

Njëri prej këtyre problemeve tani është evituar, ndërsa dy tjera mbetin akoma problem dhe do të duhet të ishin prioritet për vitet në vazhdim. Kështu në vitin 2009 pjesa dërrmuese e shkollave në Komunën e Lipjanit kanë qenë në gjendje të keqe infrastrukturore dhe në këtë drejtim përgjithësisht është punuar duke shënuar kështu edhe një minimum të standardit të kërkuar arsimor. Problemet të cilët aktualisht hasen në sistemin arsimor në Lipjan janë ato në shkollat e mesme, përkatësisht me numrin e madh të nxënësve në to që në shumicën e rasteve ky numër është afërsisht 40 nxënës për një klasë dhe po ashtu problem në vete paraqet mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik.

Arsimi Komunal			Personeli	
	Nr. i institucioneve	Nr. i nxënësve	Nr. i Mësimdhënësve	Nr. i personelit tjetër
Institucione parashkollore publike	1	114	8	9
Shkolla fillore publike	51	11667	672	158
Shkolla të mesme publike	3	3545	174	32
Shkolla apo kolegje private	1	/	/	/
Gjithsej	56			

Shëndetësia

Në Komunën e Lipjanit funksionojnë një QKMF, 4 QMF dhe 6 ambulant të mjekësisë familjare. Vetëm në QKMF në qytetin e Lipjanit punohet me orar 24 orësh, kurse në QMF punohet pesë ditë në javë për 12 orë në ditë. Tri ambulantë punojnë vetëm dy ditë në javë për tetë orë në ditë. Në shëndetësinë primare të Lipjanit janë të punësuar 234 punonjës, prej tyre 132 femra, ku vetëm një femër është në pozitë udhëheqëse. Sipas vetë zyrtarëve të drejtoratit, Lipjani ka mjaft kuadro shëndetësore, ka 21 specializant të mjekësisë familjare. Në mungesë të një spitali regjional në Prishtinë, rastet më të rënda të gjithë drejtohen në QKUK.

Investimet kapitale të përfunduara apo të nisura së bashku me donatorët gjatë dy viteve të kaluara në sferën e shëndetësisë kapin shifrën 532,574.48 eurove. Si investime kapitale për vitin 2012 në sektorin

shëndetësor nga ana e ekzekutivit janë planifikuar që të investohen 112 mijë euro, ku nga këto mjete do të bëhet renovimi i AMF-ve në Magure, Janjevë dhe blerja e inventarit në AMF-në në fshatin Smollushë.

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2012 vetëm në QKMF-ë në Lipjan janë ofruar shërbime të ndryshme mbi 80 mijë pacienteve, ku vetëm njësia e emergjencës ka pasur afër 20 mijë shërbime të ndryshme dhe 33 mijë shërbime të ndryshme kemi pasur në AMF-të tjera. Përkundër të arritjeve në organizimin e punëve krahasuar me vitet e kaluara, ku tani nuk kemi pritje të madhja të pacienteve dhe duke u bazuar në të gjitha këto fakte, konstatojmë se përkujdesi primarë shëndetësor duhet të jepet më shumë rëndësi nga ana e ekzekutivit të komunës së Lipjanit.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Komunën e Lipjanit përllogariten sipas Rregullores komunale mbi pronën. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i ka caktuar tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore:

Tarifat aktuale e tatimit komunal në pronë

Destinimi i objektit	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV	Norma e tatimit
Prona rezidenciale/shtëpi	400€	300€	200€	150€	0.12%
Prona rezidenciale/banesë	400€	300€	200€	150€	0.12%
Prona industriale	350€	300€	250€	200€	0.20%
Pronat bujqësore	200€	150€	100€	100€	0.15%
Garazhet	180€	150€	130€	100€	0.15%
Pronat komerciale	600€	400€	300€	200€	0.30%
Pronat të pa përfunduara	160€	120€	80€	60€	0.12%
Fushat sportive dhe pishinat	80€	80€	80€	80€	0.30%
Pronat e braktisura	400€	300€	200€	150€	0.05%
Pistat e aeroportit	-	400€	-	-	0.30%

Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Baza e të dhënave të cilën e disponon Komuna e Lipjanit është me plotë gabime, dhe ndodhë për të njëjtën pronë ti shënohet pronarit dy fatura të tatimit të ndryshme.

Në mbledhjen e 31-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit të datës 28.09.2012 është propozuar nga drejtorja e financave një projekt rregullore e re mbi tatimin në pronë, por që nga kuvendarët e Kuvendit komunal nuk është aprovuar por është shtyrë për një mbledhje tjetër.

Tarifat e propozuara për tatim në pronë nga ekzekutivi i komunës së Lipjanit:

Kategoria e vlerësimit	Zona I	Zona 2	Zona 3	Zona 4
APARTAMENT	400.00 €	300.00 €	200.00 €	150.00 €
FUSHË SPORTIVE E HAPUR	80.00 €	80.00 €	80.00 €	80.00 €
FUSHË SPORTIVE E MBYLLUR	80.00 €	80.00 €	80.00 €	80.00 €

KOMERCIALE E PASHFRYTZUAR	420.00 €	280.00 €	210.00 €	140.00 €
SHTËPI	400.00 €	300.00 €	200.00 €	150.00 €
DYQAN	600.00 €	400.00 €	300.00 €	200.00 €
ZYRE	600.00 €	400.00 €	300.00 €	200.00 €
PUNISHTE	350.00 €	300.00 €	250.00 €	200.00 €
FABRIKË	350.00 €	300.00 €	250.00 €	200.00 €
DEPO/MAGAZINË	350.00 €	300.00 €	250.00 €	200.00 €
GARAZHË/PARKING	180.00 €	150.00 €	130.00 €	100.00 €
BUJQËSORE	200.00 €	150.00 €	100.00 €	100.00 €
HOTEL	600.00 €	400.00 €	300.00 €	200.00 €
RESTORANT	600.00 €	400.00 €	300.00 €	200.00 €
PISHINË	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
E PAKLASIFIKUESHME	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
E BRAKTISUR	400.00 €	300.00 €	200.00 €	150.00 €
E PAPËRFUNDUAR	160.00 €	120.00 €	80.00 €	60.00 €
REZIDENCIALE/JOPRIMARE	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
FUSHË SPORTIVE	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
PISHINË DHE FUSHË SPORTIVE	80.00 €	80.00 €	80.00 €	80.00 €
PASURITË E PËRJASHTUARA	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Pistat e Aeroportit Nderkombetar te Prishtinës		400.00 €		

Nr	Lloji i pronës	Norma e tatimit
1	PËR BANIM	0.15%
2	PËR AFARIZËM	0.30%
3	SOCIAL/KULTUROR/INSTITUCIONAL	0.30%
4	SHËRBIME	0.30%
5	TRANSPORT	0.30%
6	INDUSTRI	0.20%
7	REKREACION	0.30%
8	BUJQËSI	0.15%
9	E PAKLASIFIKUESHME	0.00%
10	E PAPËRFUNDUAR	0.15%
11	E BRAKTISUR	0.15%
12	E BANUAR	0.15%
13	GARAZHË	0.15%
14	E PERJASHTUAR	0.00%
15	E LIRUAR NGA TATIMI	0.00%
16	INDUSTRIA PËRPUNUESE	0.20%
17	Pistat e Aeroportit Nderkombetar te Prishtinës	0.15%

Sektori i subvencioneve për zhvillimin e bujqësisë

Zhvillimi lokal ekonomik është një prej fushave të kompetencave vetanake të komunave. Në këtë drejtim subvencionimi në bujqësi paraqet një fushë mjaft të rëndësishme përmes të cilave bëhet inkurajimi i zhvillimit të bujqësisë dhe shfrytëzimit të tokës. Kjo edhe pse subvencionet direkte nuk janë forma e vetme e përkrahjes së bujqve. Ndihamat kanë për qëllim ngritjen e performancave dhe kapaciteteve të sektorit të cilit i dedikohet. Bujqit në Komunën e Lipjanit ashtu si në tërë Kosovën përballen me probleme dhe vështirësi të mëdha, prandaj komuna duhet të jetë e gatshme të rrisë performancën e saj në ndihmën dhe përforsimin e këtij sektori shumë të rëndësishëm për të gjithë qytetarët edhe pse gjatë fushatës elektorale kryetari i komunës Z.Shukri Buja kishte premtuar që Lipjanin do të shndërroj në një qendër agrobiznesi.

Në kuadër të subvencioneve për sektorin e bujqësisë Komuna e Lipjanit në këtë vit ka ndarë një shumë prej rreth 13 mije euro që është shumë pak. Gjatë këtij viti bujqve u janë premtuar edhe mbështetja për mbjelljet pranverore me misër dhe patate të cilat për shkak të vonesës së miratimit të buxhetit akoma fermerët nuk kanë marrë paratë e premtuara.

Ndarja e këtyre mjeteve mjaftë të nevojshme për zhvillimin e bujqësisë në Komunën e Lipjanit po behët në një kohë të vonshme kur dihet se bujqit kanë shpenzuar paratë e tyre në mbjelljen e këtyre kulturave bujqësore. Komuna do të duhej të bënte ndarjen e këtyre mjeteve financiare përgjatë muajit përkatës, kohë kjo kur kultivohen këto kultura bujqësore. Me këtë rast komuna do të duhej të jetë më e përgjegjshme në plotësimin me kohë të obligimeve ndaj qytetarëve. Një mangësi tjetër vërehet tek mos-definimi i qartë i shpërndarjes së parave. Në këtë rast nuk specifikohet ndarja e mjeteve në raport me numrin e aplikantëve. Nëse numri i të interesuarve është i madh atëherë edhe shuma e mjeteve të përfutuara nga fermerët do të jetë e vogël. Pra më këtë rast vijmë në përfundim se shuma e mjeteve të ndara për subvencionimin e fermerëve është simbolike në krahasim me shpenzimet e bujqve dhe mundin e tyre.

Rekomandimet:

1. Angazhim më i madh i Kryetarit të Komunës në përmbushjen e premtimeve elektorale;
2. Menaxhim më i mirë dhe transparencë më e madhe në shpenzimin e fondeve publike;
3. Ofrim i qasjes në informacion dhe dokumentacion për të gjitha palët e interesuara;
4. Komunikim më kualitativ me media;
5. Organizimi më i shpeshtë i takimeve publike me qytetarë veçanërisht në fazën e përpilimit të projekteve kapitale dhe buxhetit komunal;
6. Marrja parasysh e propozimeve të qytetarëve për investime kapitale sipas mundësive buxhetore;
7. Rifreskimi i kabinetit qeveritar i kryetarit të Komunës Shukri Buja me persona më energjik në disa drejtori në pjesën e dytë të këtij mandati;

8. Në fillim të vitit të paraqitet në Kuvendin Komunal, Plani Dinamik i realizimit të projekteve nga Lista e Investimeve Kapitale;
9. Mbikëqyrje më efikase e realizimit të punëve në projektet kapitale, veçanërisht në projektet infrastrukturore;
10. Mbrojtje më e mirë e pronës publike mbi baza ligjore ,
11. Përmirësimi i bazës të dhënave mbi tatimin në pronë,
12. Në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, Statutit komunal, Ligjit për transparencë dhe Rregullores komunale për transparencë të datës 20.03.2009. Duhet dhe është obliguar komuna të publikojë informacionet mbi aktivitet që është duke i zhvilluar.
13. Kuvendi Komunal I Lipjanit është i obliguar nga vetë rregullorja që e ka miratuar të datës 20.03.2009. dhe nga ligji për vetëqeverisje lokale,statuti komunal, Udhëzimi administrativë të MPL 2008/03. Që sa më shpejtë të hartojë një plan të veprimit për transparencë të aktiviteteve të saj karshi qytetarëve të saj.
14. Racionalizimi i shpenzimeve të telefonisë mobile nga ana e ekzekutivit komunale
15. Integrimin e një programi kompjuterikë kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacione për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë,
16. Automatizimi i sistemit të faturimit,

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shkurt-Qershor, 2012.
2. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Vetëqeverisje lokale. - http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf
3. Komuna e Lipjanit. Statuti i Komunës së Lipjanit - <http://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/Statut/Statuti-i-aprovuar,-me-26-09-2008-pdf.pdf.aspx>
4. Zyra e Auditorit të përgjithshëm. Raporti i Auditorit për Komunën e Lipjanit për vitin 2011. - http://www.oag-rks.org/repository/docs/Lipjan_31_12_2011_Final_alb_616502.pdf
5. Komuna e Lipjanit. Raporti i shpenzimeve janar – dhjetor 2010.
6. Komuna e Lipjanit. Raporti i shpenzimeve janar – dhjetor 2011.
7. Komuna e Lipjanit. Raporti i punës së ekzekutivit komunal 2010.
8. Komuna e Lipjanit. Raporti i punës së ekzekutivit komunal 2011.
9. Ueb faqja zyrtare e Komunës së Lipjanit. <http://kk.rks-gov.net/lipjan/Home.aspx>
10. Tabelat e Buxhetit të Qeverisë së Kosovës për vitin 2011. <http://mf.rks-gov.net/sqal/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiigendrore.aspx>
11. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Statistikat e arsimit në Kosovë. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
12. Raportet vjetore 2010 -2011 të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCannual&PPRCMenu_OpenNode=90
13. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Lipjanit. - https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=11419. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Janar-Qershor 2012,
14. Raportet javore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit Janar-Nëntor 2012,
15. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit Janar-Nëntor 2012,
16. Komunikatat për media të YAHR-it Janar-Nëntor 2012.

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center

